



Think Ahead



IEKA

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL
TË AUTORIZUAR TË SHQIPËRISË

NEWS release

17 Nëntor 2025 - ACCA, BMP dhe IEKA nënshkruajnë një Marrëveshje Bashkëpunimi!

Viti 2025 shënon një fazë të re bashkëpunimi ndërmjet ACCA, BMP dhe IEKA, në dobi të anëtarëve të tyre.

Një Marrëveshje Bashkëpunimi është nënshkruar nga ACCA (Association of Chartered Certified Accountants), Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) dhe Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA).

Marrëveshja mbështetet në bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet palëve gjatë viteve të fundit, duke përfshirë punën e përbashkët në njohjen e kualifikimeve, vlerësimin e programeve të edukimit profesional dhe zhvillimin e rrugëve të qarta për anëtarësimin dhe shkëmbimin e të dhënave.

Caitriona Allis, drejtuesja e ACCA Europe, është shprehur se: *“Qëllimi ynë ka qenë të krijojmë një kuadër të qartë dhe të përputhshëm që rregullon marrëdhënien ndërmjet sistemeve të kualifikimit të ACCA dhe IEKA, në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kjo marrëveshje bashkëpunimi e formalizon këtë kuadër. Ai përcakton mënyrën se si të dy institucionet do të njohin elemente të strukturave përkatëse të kualifikimit, veçanërisht në lidhje me kërkesat për auditimin, duke siguruar njëkohësisht përputhshmëri të vazhdueshme me mjedisin rregullator shqiptar.”*

Z. Dritan Fino, Kryetar i BMP, është shprehur se: *“Ky moment përfaqëson një nga objektivat afatgjata të BMP si autoritet për mbikëqyrjen publike: në lehtësimin e tërheqjes, në vendin tonë, së profesionistëve më të kualifikuar të kontabilitetit, duke forcuar kapacitetet profesionale dhe rritur cilësinë e auditimit. Marrëveshja vendos gjithashtu standarde të qarta bashkëpunimi, veçanërisht sa i përket shkëmbimit në kohë reale të informacionit për proceset disiplinore. Ajo garanton zbatimin e qëndrueshëm të standardeve për vlerësimin e integritetit dhe reputacionit të mirë të anëtarëve të përbashkët, duke siguruar mekanizma të fortë për mbrojtjen e interesit publik.”*

Z. Artan Xhiani, Kryetar i IEKA, është shprehur se: *“Marrëveshja mbështet njohjen e kualifikimeve dhe integritetin e profesionistëve të ACCA në sistemin Shqiptar, në përputhje me kërkesat ligjore dhe provimet e aftësive profesionale. Ky është një hap i rëndësishëm drejt forcimit dhe përmirësimit të cilësisë së edukimit profesional, duke theksuar njëkohësisht rolin thelbësor të IEKA si organizata përgjegjëse për zhvillimin profesional, etikën dhe aftësitë e audituesve ligjorë në Shqipëri.”*

Anëtarët e ACCA-s që dëshirojnë të anëtarësohen pranë IEKA duhet të aplikojnë pranë IEKA-s (<https://ieka.al/>).

Për pyetje nga media, kontaktoni: andrea.stanciu@accaglobal.com; info@bmp.al; info@ieka.al

Rreth BMP

Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), me statusin e një autoriteti të pavarur rregullator, është krijuar për të realizuar mbikëqyrjen publike dhe për të siguruar që audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese janë subjekt i një sistemi që jep siguri për cilësinë. Mbikëqyrja e profesionit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese realizohet nga BMP, si drejtpërdrejt, duke mbikëqyrur të gjithë audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese, ashtu edhe përmes mbikëqyrjes së veprimtarisë së organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

Qëllimi i sistemit të mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese është rritja e garancisë që auditimet ligjore të kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar dhe me kujdes të lartë profesional, në shërbim të interesit publik.

Për më shumë informacion, vizitoni <https://bmp.al/>

Rreth IEKA

Misioni i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë është garantimi i ushtrimit të duhur të profesionit, ruajtjen e integritetit dhe pavarësisë së anëtarëve të tij, si dhe siguri i mbikëqyrjes së trajnimit të tyre profesional.

Objektivi kryesor i organizatës profesionale të audituesve ligjorë (IEKA) është përmirësimi i njohurive dhe zbatimi në praktikë i standardeve të cilësisë më të lartë, në përputhje me zhvillimet globale.

Për më shumë informacion, vizitoni <https://ieka.al/en/home-2/>

Rreth ACCA

ACCA është Association of Chartered Certified Accountants, një komunitet global në zhvillim me **257,900 anëtarë dhe 530,100 anëtarë të ardhshëm në 180 vende**, që mbajnë vlerat më të larta profesionale dhe etike. Ne besojmë se kontabiliteti është një profesion themelor i shoqërisë që mbështet si sektorin privat ashtu edhe atë publik. Kjo është arsyeja pse ne jemi të përkushtuar ndaj zhvillimit të një profesioni të fortë global të kontabilitetit dhe shumë përfitimeve që ky i sjell organizatave, individëve dhe shoqërisë.

Kualifikimet tona zhvillojnë profesionistë me mendim të orientuar drejt së ardhmes dhe me aftësi financiare dhe biznesi thelbësore për krijimin e ekonomive të qëndrueshme dhe shoqërive të lulëzuara. Çdo ditë, kontabilistët profesionistë të ACCA mbështesin njerëzit dhe organizatat në marrjen e vendimeve të shëndosha dhe të duhura. Ne ndërtojmë besimin publik duke krijuar një profesion gjithëpërfshirës me njerëz nga të gjitha prejardhjet, të lidhur nga një kod i përbashkët global i etikës dhe të përkushtuar për të përditësuar aftësitë e tyre për të përmbushur nevojat në ndryshim të vazhdueshëm.

Që nga viti 1904, të qenit një forcë për të mirën publike është ngulitur në qëllimin tonë dhe kjo fuqizon gjithçka që bëjmë. Si t'u ofrojmë të gjithëve, kudo, mundësinë për të hyrë në një karrierë të kënaqshme në kontabilitet. Duke punuar në partneritet me ekonomitë në zhvillim për të krijuar organizatat e tyre profesionale të kontabilitetit dhe për të rritur ekosistemet e tyre financiare. Përmes ndarjes lirisht të hulumtimit tonë të përparuar që përgjigjet pyetjeve të sotme dhe na përgatit për të nesërmen. Dhe duke mbështetur familjen tonë globale të anëtarëve, anëtarëve të ardhshëm dhe partnerëve dhe duke zhvilluar profesionin për brezin e ardhshëm.

Ne po e ripërcaktojmë kontabilitetin për një botë të ndryshuar.

Për më shumë informacion, vizitoni www.accaglobal.com